

STATUT

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “HANA 2024” SH.P.K

Hyrje

Sot në datën 01/12/2024 sipas Aktit të themelimit me cilësinë e administratorit po formulojmë këtë status të Shqoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “HANA 2024” SH.P.K Shoqëria gjëzon statusin e personit juridik shqiptar dhe si e tillë në respektim të neneve 24-38 të Kodit Civil dhe ligjit Nr.9273, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtre të Regjistrimit" fiton personalitet juridik e për pasoje do të fillojë aktivitetin e saj pas regjistrimit në Regjistrin Tregtarë të Qëndrës Kombëtare të Biznesit si dhe në organet timore, në zbatim të neneve 20/1, 26,28,32,35, të po këtij ligji, si dhe gjithashtu mbështetje të Nenit 230 të ligjit nr 9901 datë 14/04/2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet duke u mbeshtetur në dispozitat e këtij Statusi.

Kreu I

Themeli, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 01/12/2024, u krijuua një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“HANA 2024” SH.P.K

(2) Themeluesite shoqërisë janë si me poshte vijon;

1. Z. Rezart Merkaj, atësia Myftar, lindur në Patos në datë 04/06/1982, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr I20604080M lëshuar në datën 24/09/2020.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Aktiviteti i shoqerise me përgjegjesi te kufizuar eshte “Restorant, stacion plazhi, etj”.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar. Ajo do të drejtobet nga Administratori, Z. Rezart Merkaji cili është dhe ortaku I vetem ishoqërisë. Shoqëria mund të prishet ose të pushojë aktivitetin e saj me një vendim të Asamblesë së Përgjithësme të ortakëve, në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe statutit të shoqërisë.

Neni 4:
Selia

(1) Shoqëria do të ketë selinë e saj ligjore në adresën:

"Rr. Persefoni Kokedhima nr. 12, Lagija Skaloma, Qeparo, Shqiperi"

Neni 5:
Vula

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Neni 6

Kapitali themeltar

1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjete mijë) i ndarë me 1 kuote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku **Z. Rezart Merkaj** Zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjete mijë) Lekë që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Depozitimi i kapitalit

Kapitali themeltar do të depozitohet pranë njërsë prej bankave të nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, ku dhe do të celet llogaria rrjedhëse e kësaj shoqërie.

Neni 8
Organ i Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.


Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Neni 9
Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorët e shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorët e një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.



Të dhënat e identifikimit:

I. Z. Rezart Merkaj, atësia Myftar, lindur në Patos në datë 04/06/1982, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr I20604080M lëshuar në datën 24/09/2020.

Neni 10
Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme pë rimiratim;
- d) krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në raste kur:


- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllitet me 31 Dhjetor.



Neni 12

Ndarja e Fitimit, Rezervat

Pas perballimit te detyrimeve,taksave,tatimeve,shpenzimeve te ndryshme si dhe pagesa e punonjesve te punesuar si dhe perballimit te detyrimeve ndaj te treteve. Ortaket themelues dhe kur eshte rasti Asamblea, qe aprovojne bilancin duhet te destinoje 1/20 te fitimit vjetor te shoqerise te realizuar per krijimin e nje fandi te emeruar " **REZERVE E DOMOSDOSHME**". Ky detyrim nuk vlen per rastin kur "Rezerva e domosdoshme" arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Fitimi qe perbehet nga diferenca midis fitimit vjetor finaciari te sapomyllur dhe vleres se fondit "Rezerve e domosdoshme" konforme ketij **n eni**, I kalon ortakut te vetem ose ortakeve kur eshte rasti (ne rastin konkret) sipas perqindjes se secili prej tyre zoteron ne kapitalin e shoqerise te nenshkruar prej tij (ortakut) personalisht. Konkretisht, pas respektimit te sa me siper fitimi qe i takon secilit prej ortakeve dhe konkretisht ortakut te vetem, Ortaku ose Asambleja e ortakeve me vendim mund te vendose per formimin e fondeve te tjera dhe menyren e shperndarjes se tyre, mjafton qe kjo shperndarje te mos sjelle zvogelim

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Statuti i shoqerise "**HANA 2024**" **SHPK** perpilohet ne 2 kopje origjinalë secila dhe nenshkruhet ne cdo fletë prej ortakeve themelues te saj ,pasi iu lexua ne deklarojne se e kuptojne dhe e aprovojne ate si te tille.

ORTAKET
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HANA 2024” SH.P.K

Z. Rezart Merkaj

